



Thirrje publike

Këshilli i Qytetit të Shkupit, në propozim të Kryetarit të Qytetit të Shkupit, në seancën e mbajtur më datën 27.11.2019, votoi Programin me të cilin përcaktohen llojet e shfrytëzimit të privilegjuar të transportit urban publik, kategoritë e personave me nevoja të posaçme të cilët gëzojnë të drejtën e shfrytëzimit të privilegjuar të transportit publik urban, si dhe kushtet dhe procedura e përfitimit të kësaj të drejte.

Qytetarët e interesuar, personat me pamje të dëmtuar, me dëgjim të dëmtuar, personat me dëmtime trupore, personat që ballafaqohen me pengesa intelektuale, personat me sëmundje të veshkave, persona me autizem, si dhe invalidët e punës, pensionistët me invaliditet dhe invalidët e luftës, të drejtën e shfrytëzimit të privilegjuar të transportit publik urban mund ta realizojnë përmes shoqatave përkatëse civile, të organizuar në territorin e qytetit të Shkupit.

Për realizimin e të drejtës së shfrytëzimit të privilegjuar të transportit publik gjatë vitit 2020, personi i interesuar me nevoja të posaçme, parashtron kërkesën deri te shoqata civile në të cilën është i anëtarësuar.

Shoqatat civile, listën finale të kërkuësve të cilët i plotësojnë kushtet dhe për të cilët propozojnë fitimin e biletave, i dorëzojnë deri te Qyteti i Shkupit, më vonë deri më 13.12.2019.

Për informacione plotësuese, përfaqësuesit e shoqatave të paraqiten në telefonin 3 297 – 321.